



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01. Nr. 593/25 Dt. 17.10.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenin 27 dhe 28 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve, vendimit me numër 01-108/25, të datës 06.02.2025, për aprovimin e shumave për mbështetje për kategoritë e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare, bazuar në procesverbalin e Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare të datës 12.09.2025, pas kërkesës së Drejtorisë së Shëndetësisë, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Shëndetësisë, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për të sëmurit me sëmundje malinje (CA), tumore beninje të rënda, tumore të tjera beninje, fëmijë deri 18 vjeç me sëmundje të rënda, zyrtarët publik të Komunës së Prizrenit të sëmurë me sëmundje të rënda dhe qytetarë të Komunës të sëmurë me sëmundje tjera të rënda si në vijim:

- 1.1. Personat e mëposhtëm që bëjnë pjesë në kategorinë e të sëmurëve me sëmundje malinje (CA) të përcaktuar në nenin 27 par.2.1 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, bazuar në vendimin 01. Nr. 108/25, të datës 06.02.2025, për aprovimin e shumave për mbështetje për kategoritë e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare, të mbështeten me nga 400 euro:

1. [REDACTED]	2. [REDACTED]	3. [REDACTED]	4. [REDACTED]
5. [REDACTED]	6. [REDACTED]	7. [REDACTED]	8. [REDACTED]
9. [REDACTED]	10. [REDACTED]	11. [REDACTED]	12. [REDACTED]
13. [REDACTED]	14. [REDACTED]	15. [REDACTED]	16. [REDACTED]
17. [REDACTED]	18. [REDACTED]	19. [REDACTED]	20. [REDACTED]
21. [REDACTED]	22. [REDACTED]	23. [REDACTED]	24. [REDACTED]
25. [REDACTED]	26. [REDACTED]	27. [REDACTED]	28. [REDACTED]
29. [REDACTED]	30. [REDACTED]	31. [REDACTED]	

- 1.2. Personat e mëposhtëm që bëjnë pjesë në kategorinë e të sëmurëve me tumore benignë të rënda, siç janë: tumoret e pa operueshme, tumoret e trurit, tumoret e pankreasit dhe tumoret e mëlqisë, të përcaktuar në nenin 27 par.2.2 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, bazuar në vendimin 01. Nr. 108/25, të datës 06.02.2025, për aprovimin e shumave për mbështetje për kategoritë e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare, të mbështeten me nga 400 euro:

1. [REDACTED]	2. [REDACTED]	3. [REDACTED]
---------------	---------------	---------------

- 1.3. Personat e mëposhtëm që bëjnë pjesë në kategorinë e fëmijëve deri në 18 vjeç të sëmurë me sëmundje neuromuskulare, metabolike, me diabet insulin vartës, me defekte të lindura dhe të fituara të zemrës dhe fibroza cistike të përcaktuar në nenin 27 par.2.4 të Rregullores Komunale nr. 001-011-20 datë 03.01.2024, bazuar në vendimin 01. Nr. 108/25, të datës 06.02.2025, për aprovimin e shumave për mbështetje për kategoritë e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare, të mbështeten me nga 400 euro:

1. [REDACTED]	2. [REDACTED]	3. [REDACTED]	4. [REDACTED]
5. [REDACTED]	6. [REDACTED]		

- 1.4. Personat e mëposhtëm që bëjnë pjesë në kategorinë e të sëmurëve me sëmundje të tjera rënda siç janë: ciroza e mëlqisë – shkalla 3 dhe 4, kardiomiopati të dillatative të zemrës – shkalla 3 dhe 4, gjakderdhjet në tru dhe skolioza multiple, të përcaktuar në nenin 27 par.2.6 të Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, bazuar në vendimin 01. Nr. 108/25, të datës 06.02.2025, për aprovimin e shumave për mbështetje për kategoritë e përcaktuara me rregullore për mbështetje financiare, të mbështeten me nga 400 euro:

[REDACTED]

2. Shumat e lejuara, të përshkruara si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.

